



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA	AGJENCIA SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E DHËNAVE PERSONALE
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA	NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE	
Org. Jshut: 01	Nr. Prot. Br. Prot. No: 48
Nr. i faqeve: 02	Data Datum: 30.04.2012
PRISHTINË/A	
Nr. 48/12	

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

Datë: 30.04.2012

Në mbështetje të nenit 61 paragrafi 2 dhe nenit 62, 64 paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenit 49 paragrafi 1.3 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Shtetëror të Agjencisë morën:

### V E N D I M

1. Urdhërohet Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve të largoj të gjitha kamerat së bashku me sistemin përcjellës-mbështetës për vëzhgimin me kamerë nga objekti i Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve SHOTA.
2. Urdhërohet për marrjen e masave, dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Afati për zbatimin e vendimit është tetë (8) ditë nga dita e pranimit të vendimit.
4. Agjencia të lajmërohet me shkrim lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Gjatë kontrollit të bërë në Ansambllin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve SHOTA për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit, është konstatuar se vendimi nr 22/12 i datës 30.04.2012 nuk është zbatuar.

Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve SHOTA është institucion varës i juaji, obligimi i zbatimit të vendimeve me qëllim të zbatimit të ligjit është detyrë dhe obligim edhe i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve SHOTA respektivisht drejtori i saj nuk ka nxjerr vendimet e nevojshme sa i përket vëzhgimit me kamerë të parapara me nenin 62 paragrafi 2 të Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu ka qenë detyrë dhe obligim i drejtorit të Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve SHOTA të bëjë njoftimin e personelit të punësuar lidhur me instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë. Duke pasur parasysh me këtë rast që kemi të bëjmë edhe me vëzhgimin me kamerë në hapësirat e punës, personeli i punësuar është dashur të informohet me shkrim. Gjendja e konstatuar është se nuk ka asnjë njoftim që është instaluar sistemi i vëzhgimit me kamerë, njoftim ky i paraparë që të jetë në një vend të dukshëm dhe të bëhet publik sipas nenit 61 paragrafi 2 i Ligjit 03/L-172, dhe nuk kemi njoftim me shkrim të punësuarve-subjekteve për vendosjen e kamerave në hapësirat e punës, njëkohësisht punëtorët është dashur të jenë njoftuar se ku ato kamera ndodhen, obligim i cili është paraparë me nenit 64 paragrafi 4 të Ligjit 03/L-172.

Gjendja e konstatuar është se kamerat e vendosura në hapësirat e punës janë në kundërshtim të plotë me nenin 64 të ligjit 03/L-172 dhe në kundërshtim me qëllimin për të cilin ato kamera mund të vendosen, ngase vëzhgimi me kamerë mund të bëhet vetëm në rastet kur është e





Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

domosdoshme për sigurinë e të punësuarve, sigurinë e pronës dhe ruajtjen e informacioneve sekrete, nëse ky qëllim nuk mund të arrihet me mjete më të lehta.

Duke pasur parasysh natyrën e punës të Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve SHOTA, vendosja e kamerave nuk plotëson asnjërin nga këto kritere, duke theksuar në këtë rast, hapësirën ku janë pasuria-gjërat me vlerë të Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve SHOTA, nuk kanë qenë të mbuluara me kamerë. Gjersa vendi ku është bërë monitorimi i vëzhgimit me kamerë, zyra e drejtorit të Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve SHOTA, gjë që është në kundërshtim të drejtpërdrejt me kriteret e qëllimit të vendosjes së sistemit me kamerë.

Nëse Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve SHOTA do kishte ose ka për qëllim ruajtjen e pronës, pasurisë dhe sigurinë e të punësuarve, monitorimi duhej të ishte bërë nga organi përgjegjës i cili ka për detyrë ruajtjen e pronës, pasurisë dhe sigurinë e objektit dhe personelit që mund të jetë; policia apo ndonjë kompani private e kontraktuar e cila ofron këto shërbime. Në bazë të faturës me numër 16. 009-2010 Ansambli i valleve Shota ka pranuar 6 (gjashtë) kamera. Gjatë inspektimit ne kemi arritur të lokalizojmë vetëm 5 (pesë) kamera prej të cilave 3 (tri) kamera mbulojnë vëzhgimin në hapësirat e jashtme të objektit të Ansambilit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve SHOTA, dhe dy kamera të cilat kanë qenë të kamufluara në dy kuti të bardha, kuti të cilat shërbejnë si kuti shpërndarëse të instalimit të rrjetit elektrik. Duke ditur që kamerat e shfrytëzuara në hapësirat e brendshme janë kamera të një teknologjie të lartë e cila mund të kamufluhet lehtë, dhe duke pasur parasysh që një (1) kamerë ende mungon, për të qenë të sigurt që të mos ndodh shkelja e vazhdueshme e Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, është e domosdoshme largimi i të gjitha kamerave së bashku me gjithë sistemin instalues mbështetës.

Vëzhgimi me kamerë mund të filloj vetëm pasi të verifikohet plotësimi i dispozitave të Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, për vëzhgim me kamerë nga ana e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe me instalimin e një sistemi komplet të ri

#### Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror

Mentor Hoxhaj

Bekim Demiri

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Ministrisë Kulturore Rinisë dhe Sporteve
- Arkivit të Agjencisë